



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr. 104/02-7673/21
Kaçanik, 18.03.2021

Në bazë të nenit 12.2 (d) lidhur me nenin 17 (h) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare Nr. 28/04 Qershor 2008), të nenit 20 pika 1, të Ligjit për Arsimin Parauniversitar Nr. 04/L-032, nenit 5 pika (d) të Ligjit për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës Nr.03/L-068, të nenit 6 pika 3 paragrafi 1 dhe të pikës 9 të Udhëzimit Administrativ (MASH) me Nr. 151/2020, për detyrat dhe përgjegjësit e drejtorit dhe zëvendës drejtorit të institucionit publik edukativo-arsimor dhe aftësues parauniversitar në Republikën e Kosovës, procedurat e zgjedhjes dhe emërimit, përfundimit të kontratës dhe emërimit të përkohshëm, të Propozim Vendimi të Kryetarit të Komunës 01Nr. 104/02-7673/2021 prej datës 10.03.2021, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e mbajtur me 18 Mars 2021, mori këtë:

V E N D I M
PËR EMËRIMIN E KOMISIONIT PËRZGJEDHËS PËR DREJTOR
TË INSTITUCIONEVE ARSIMORE

1. Me këtë Vendim, Aprovohet Propozim Vendimi i Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës (DAK) 01Nr. 104/02-7673/2021- Për formimin e Komisioni përzgjedhës për zhvillimin e procedurës së rekrutimit për kandidatët që konkurrojnë për vende të lira të punës: Drejtor të Institucioneve Arsimore në Komunën e Kaçanikut, në këtë përbërje:

- 1.1. Hajrush Dullovi, Zyrtar i lartë i arsimit, Kryesues i komisionit;
- 1.2. Florije Zeneli, Drejtoreshë në SHFMU "Idriz Seferi" Bob; Anëtare; dhe
- 1.3. Një(1) përfaqësues i MASH-it, Anëtar (propozohet nga ministria).

2. Komisioni përzgjedhës do të veprojë sipas udhëzimeve të parashikuara, respektivisht Udhëzimit Administrativ (MASH) me Nr. 151/2020.

3 Ky Vendim hyn në fuqi sipas nenit 17 të Rregullores (MAPL) Nr.01/2017- për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të komunës, ndërkaq vlen për një vit shkollor.

4. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Drejtoria e Arsimit dhe mekanizmat tjerë relevantë.

Me këtë vendim njoftohen:

1. Kryetari i Komunës;
2. Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës; dhe
3. Arkivi.

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

REPUBLICA E KOSOVES QEVERIA	
MINISTARSTVO OBRAZOVANJA, SHKENCES, TEKNOLOGJISE DHE INOVACIONIT MINISTRY OF EDUCATION, SCIENCE, TECHNOLOGY AND INNOVATION	
Nr. Org. Org. Unit	2
Nr. Prot. Prot. No.	565
Nr. Detyrues Duty No.	08.04.2021
Nr. Detyrues Duty No.	08.04.2021
Ministria e Administrimit të Qytetit Lokal Ministry of Local Government Administration	
Data Date	
08.04.2021	
Nr. Detyrues Duty No.	020-246/3
-VI-	

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit / Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacije / Ministry of Education, Science, Technology and Innovation

Zyra e Sekretarit të përgjithshëm/Kancelarija Generalnog Sekretar/Office of the General Secretary

REFERENC-Ë:	
PËR/ZA/TO:	Trim Berisha, u.d. i sekretarit të përgjithshëm në MPL
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Agim Bërdyna, u. d. i sekretarit të përgjithshëm/MASH
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Përgjigje për shqyrtimin e ligjshmërisë së aktit të komunës së Kaçanikut me nr. 020-246/1 e dt. 22.03.2021

Të nderuar,

Lidhur me kërkesën për shqyrtimin e ligjshmërisë së aktit të komunës së Kaçanikut për formimin e komisionit për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve në shkollat e Komunës së Kaçanikut, opinioni ynë është si në vijim:

Në bazë të nenit 6 të Udhëzimit administrativ me nr. 151/2020, për detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit dhe zëvendës drejtorit të institucionit publik edukativo-arsimor dhe aftësues parauniversitar në Republikën e Kosovës, procedurat e zgjedhjes dhe emërimit, përfundimit të kontratës dhe emërimit të përkohshëm, përfaqësuesit e emëruar korrespondojnë me UA.

Me respekt!